

VENDIM
Nr. 932, datë 26.12.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, NË FAVOR TË AVOKATURËS SË SHETIT, PËR MBULIMIN E PAGESËS SË SHPENZIMEVE TË KONSULENTIT NDËRKOMBËTAR PËR KONFLIKTIN ME SHOQËRINË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit e Ministrër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “Mallra dhe shërbime”, në favor të Avokaturës së Shtetit, t’i shtohet fondi 320 000 (treqind e njëzet mijë) euro + TVSH, për mbulimin e pagesës së shpenzimeve për kontraktimin e konsulentit ndërkombëtar për asistencën për rastin e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha